

VENDIM
Nr. 721, datë 2.9.2015

PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESË NË VENDIMIN NR. 718, DATË 29.10.2004, TË KËSHILLIT TË MINISTRAVE, "PËR LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR SI FINANCUES TË TERRORIZMIT", TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 5, pika 1, 14, pika 1, 18, pika 1, 25, pika 1, dhe 28, pika 1, të ligjit nr. 157/2013, "Për masat kundër financimit të terrorizmit", me propozimin e ministrit të Punëve të Jashtme, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Në listën e personave të shpallur si financues të terrorizmit sipas rezolutës së Këshillit të Sigurimit ("Lista e OKB-së"), që i bashkëlidhet vendimit nr. 718, datë 29.10.2004, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, bëhen ndryshimi dhe shtesa e mëposhtme:

a) Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", regjistrohet individi i renditur në shkronjën "a" të listës, "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas ndryshimeve në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues, për organizatën Al-Qaida.

b) Në listën e shkronjës "C", "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", regjistrohet individi i renditur në shkronjën "c" të listës, "Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida", që i bashkëlidhet këtij vendimi, sipas shtesës në listën e konsoliduar të Këshillit të Sigurimit të OKB-së, për personat që janë anëtarë, bashkëpunëtorë apo financues për organizatën Al-Qaida.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR
SI FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e ndryshuar në **"Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida"**:

1. AL SAYYID; AHMED; FATHI; HUSSEIN ELIWAH.

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personin, emri i të cilit është radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.

AZHURNIMI NË LISTËN E PERSONAVE TË SHPALLUR
SI FINANCUES TË TERRORIZMIT SIPAS REZOLUTAVE TË KËSHILLIT TË SIGURIMIT (LISTA E OKB-së)

C. LISTA E INDIVIDËVE ANËTARË OSE BASHKËPUNËTORË ME ORGANIZATËN AL-QAIDA

a) Lista e shtuar në **"Lista e individëve anëtarë ose bashkëpunëtorë me organizatën Al-Qaida"**:

1. THE ARMY OF EMIGRANTS AND SUPPORTERS.

Shënim. Gjenealitetet e tjera për personat, emrat e të cilave janë radhitur më sipër, mbahen në Drejtorinë e Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave.